



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 107, datë 02.08.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z.KLODIAN RADO NË VENDIN VAKANT
PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I
EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës **30.07.2019 dhe 02.08.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË

Z. Klodian Rado

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të z.Klodian Rado, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **znj. Margarita Buhali**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është edhe z. Klodian Rado.

4. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 dhe 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Margarita Buhali.

7. Z. Klodian Rado, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Klodian Rado, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 15.04.2019, kandidati Klodian Rado është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati Klodian Rado ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Klodian Rado, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/5 prot, datë 06.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Klodian Rado e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 19/34 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Klodian Rado dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Klodian Rado dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Klodian Rado, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.

b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.

c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.

ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Ttatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatit Klodian Rado.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 111 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Klodian Rado sipas ligjit nr. 138/2015.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/77 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Klodian Rado.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Klodian Rado, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 121 prot, datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 115 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 119 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 116 prot, datë 17.04.2019*).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar në pikën 19 për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr.1551 prot., datë 10.06.2019 dhe nr.730/1 prot., datë 20.05.2019.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Klodian Rado për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Klodian Rado.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Klodian Rado në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*,

Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Klodian Rado.

26. Këshilli i ka kërkuar kandidatit të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në zbatim të nenit 199 dhe 237 të ligjit nr.115/2016 i është kërkuar informacion për sa mëposhtë:

a) Në dosjen tuaj si kandidat mungon librezja e punës, e cila ju kërkohet të dorëzohet në formën e kërkuar nga ligji pranë KED për efekt të verifikimit të vjetërsisë suaj në punë.

b) Për periudhën 2003 e në vazhdim ju lutemi të na vini në dispozicion vërtetimin nga Sigurimet Shoqërore dhe Drejtoria e Tatimeve për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas pozicionit tuaj të punës të deklaruar pranë këtyre institucioneve. Ndërsa për periudhën e punës jashtë shtetit duhet të paraqisni vërtetimet nga punëdhënësi në formën e kërkuar nga ligji, ku të pasqyrohet lloji i punës i kryer. Për periudhën e punës si gjyqtar është i mjaftueshëm pasqyrimi në librezë ose vërtetimi i lëshuar nga KLGJ.

c) Duke qënë se kemi mbajtur më parë detyrën e gjyqtarit a keni aplikuar pranë organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve sipas ligjit nr.86/2016 me qëllim riemërimin në pozicionin e gjyqtarit ?

ç) Gjithashtu në zbatim të nenit 199 pika d dhe dh të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” kërkohet nga ana juaj të paraqisni vërtetim nga institucionet përkatëse se *nuk keni masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit* (përfshihen 3 vitet e fundit) dhe se nuk jeni pushuar nga puna në ndonjë rast për shkelje disiplinore. Gjithashtu me emailin e datës 12.07.2019 i është kërkuar si vijon: *Në letrën Tuaj sqaruese të datës 26.04.2019 ndër të tjera rezulton se në periudhën tetor 2004-tetor 2006 dhe tetor 2005 dhe korrik 2008, keni punuar si pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, për këtë periudhë kërkojmë nga ana Juaj të paraqisni dokumentacionin si vijon: Kontrata pune (nëse dispononi) ose vërtetime të lëshuara nga ky fakultet për kohën e punës së ofruar si pedagog i jashtëm duke specifikuar konkretisht: lëndet respektive, orët e kryera si pedagog i jashtëm e periudhën e vitit kur ajo është ofruar (gjatë gjithë vitit apo simestrale).*

27. Kandidati Klodian Rado ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me nr. 294 prot, datë 30.04.2019, si dhe me emailin e datës 21.06.2019 dhe datës 23.07.2019.

28. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidati Klodian Rado ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Ministrisë së Drejtësisë (*shkresa nr.269 prot., datë 19.04.2019*), Këshillit të Lartë Gjyqësor (*shkresa nr.271 prot., datë 19.04.2019*), Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*shkresa nr.276 prot., datë 19.04.2019*), Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë Universiteti i Tiranës (*shkresa nr.429 prot., datë 12.07.2019*), Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës (*shkresa nr.430 prot., datë 12.07.2019*).

29. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Ministria e Drejtësisë (*shkresa nr.3505/2 prot., datë 03.05.2019*), Këshilli i Lartë Gjyqësor (*shkresa nr.2331/1 prot., datë 25.04.2019*), Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*shkresa nr.3079/1 prot., datë 24.04.2019*), Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë Universiteti i Tiranës (*ska kihim përgjigje*), Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës (*shkresa nr.863/1 prot., datë 25.07.2019*).

30. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja relatore e Këshillit, z. Margarita Buhali, ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

31. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 30.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z.Klodian Rado, për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

32. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Klodian Rado.

33. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

34. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 30.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

35. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

36. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Klodian Rado.

37. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të vënë në dispozicion, që do të provonte deklaratimet e kandidatit, e ka të pamundur të japë një mendim pozitiv dhe është i mendimit se në rast se shpjegimet e dhëna nuk shoqërohen me

dokumenacionin përkates (ashtu siç parashikohet nga ligji), atëherë KED duhet të ndalojë kandidatin për vazhdimin e konkurimit. Në lidhje me pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kushti i përvojës profesionale është 15 vite si jurist dhe jo në pozicione të caktuara të këtij profesioni. Koha e studimeve në Shkollën e Magjistraturës nuk plotëson kriterin e ushtrimit të profesionit të juristit sepse në këtë kohë nuk ka ndonjë aktivitet që lidhet me ushtrimin e profesionit, përveç thellimit të njohurive në këtë fushë. Ndërsa viti i praktikës duhet të përfshihet për efekt të llogaritjes së përvojës profesionale në këtë periudhë. Ndërkohë, në lidhje me ushtrimin efektiv të profesionit të juristit gjatë kohës së anëtarësisë në shoqatë dhe detyrës së tij si jurist, në kushtet kur mungon librezja e punës, nuk ka asnjë dokument që të jetë i deklaruar si i punësuar në këtë shoqatë dhe puna është kryer në mënyrë vullnetare, për të provuar përvojën profesionale kandidati do të duhet të kishte provuar se çfarë produkti efektiv në profesion ka pasur në kuadër të anëtarësimit në shoqatë dhe/ose në departamentin e tyre juridik, apo në mbrojtje gjyqësore të personave në vështirësi. Në dosjen tonë mungojnë të tilla punime për të na bërë të mundur konkludimin në lidhje me plotësimin e këtij kriteri. Në lidhje me përvojën profesionale si pedagog i jashtëm jemi të mendimit të llogariten për këtë pozicion vitet sipas vërtetimit të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Klodian Rado për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

39. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, parashikohet se:

“3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.”

40. Në pikën 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

“1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës."

41. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.19/34 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Klodian Rado dhe personat e lidhur me të.

42. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Klodian Rado, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- ç) Nuk ka kryer deklarin të remë.
- d) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

43. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Klodian Rado në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

44. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarin e bëra nga kandidati Klodian Rado pranë ILDKPKI me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

45. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Klodian Rado.

46. Për këto arsye, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Klodian Rado ka "kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij". Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

47. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati Klodian Rado ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

48. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/77 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Klodian Rado, duke ardhur përfundimet se *“Subjekti deklarues Klodian Balil Rado, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

49. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Klodian Rado, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati “ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale:”. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

50. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Klodian Rado ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

51. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.272 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Klodian Rado, duke ardhur përfundimet se *“ Për zotën Klodian Balil Rado, nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.

52. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Klodian Rado, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

53. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidati Klodian Rado *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

54. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.730/1 prot., datë 20.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara në pikën më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Klodian Rado *“Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale.”*.

55. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.1551 prot., datë 10.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara në pikën më sipër, nga ku rezulton se *“Nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së z. Klodian Balil Rado.*

56. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidati Klodian Rado nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

57. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Klodian Rado në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

58. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Klodian Rado ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1999–2003 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidati Klodian Rado nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

59. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Klodian Rado ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Jurist/Asistent Ligjor, për periudhën “*Qershor 2003 – Tetor 2004*”, pranë Zyra Avokatore “Prof Dr Paskal Haxhi”.
- b) Jurist, për periudhën “*Tetor 2003 – Tetor 2006*”, pranë Shoqata “Qytetërim dhe Drejtësi”.
- c) Pedagog, për periudhën “*Tetor 2004 – Korrik 2009*”, pranë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.
- ç) Pedagog për periudhën “*Tetor 2005 – Qershor 2008*”, pranë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.
- d) Pedagog, për periudhën “*Tetor 2006 – Korrik 2008*”, pranë Universiteti Evropian i Tiranës, Departamenti i Shkencave.
- dh) Pedagog, për periudhën “*Tetor 2006 – Qershor 2010*”, pranë Universiteti “Justiniani I”, Fakulteti i Drejtësisë.
- f) Pedagog për periudhën “*Mars 2012 – Qershor 2012*” pranë University of Neë York Tirana.
- g) Trajner/Ekspert në Shkollën e Magjistraturës për periudhën “*Janar 2009 – Qershor 2012*” pranë Shkolla e Magjistraturës.
- h) Gjyqtar për periudhën “*Tetor 2006 – Nëntor 2007*” pranë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
- i) Gjyqtar për periudhën “*Nëntor 2007-Shtator 2015*” pranë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- j) Anëtar i Komisionit të Rekrutimeve të Pedagogëve etj., për periudhën “*Shtator 2014 – Shtator 2017*” pranë Osgoode Hall Laë School, York University, Canada.
- k) Ekspert Ligjor i Jashtëm për periudhën “*Korrik 2014 – Gusht 2016*” pranë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
- l) Ekspert Ligjor në Kanada (Freelance Expert) për periudhën “*Tetor 2015 – Gusht 2018*” pranë Gjykatat Kanadeze / Gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar/ Komisioni Shqiptar i Helsinkit.
- m) Doktorant (PhD) & Pedagog i Lëndës për periudhën “*Shtator 2012 – Gusht 2018*” pranë Osgoode Hall Laë School, York University, Canada.
- n) Pedagog për periudhën “*Tetor 2018 – Mars 2019*” pranë Universiteti Evropian i Tiranës, Departamenti i Shkencave Juridike.
- o) Pedagog për periudhën “*Prill 2019 – Aktualisht*” pranë Universiteti Evropian i Tiranës, Departamenti i Shkencave Juridike.
- p) Pedagog për periudhën “*Tetor 2018 – Aktualisht*” pranë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.
- q) Ekspert i Lartë Ligjor për periudhën “*Shtator 2018 – Aktualisht*” pranë Misioni EURALIUS V.

60. Këshilli i ka kërkuar kandidatit të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në zbatim të nenit 199 dhe 237 të ligjit nr.115/2016 i është kërkuar informacion për sa mëposhtë: (a) Në dosjen tuaj si kandidat mungon librezja e punës, e cila ju kërkohet të dorëzohet në formën e kërkuar nga ligji pranë KED për efekt të verifikimit të vjetërsisë suaj në punë. (b) Për periudhën 2003 e në vazhdim ju lutemi të na vini në dispozicion vërtetimin nga Sigurimet Shoqërore dhe Drejtoria e Tatimeve për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas pozicionit tuaj të punës të deklaruar pranë këtyre institucioneve. Ndërsa për periudhën e punës jashtë shtetit duhet të paraqisni vërtetimet nga punëdhënësi në formën e kërkuar nga ligji, ku të pasqyrohet lloji i punës i kryer. Për periudhën e punës si gjyqtar është i mjaftueshëm pasqyrimi në librezë ose vërtetimi i lëshuar nga KLGJ. (c) Duke qënë se keni mbajtur më parë detyrën e gjyqtarit a keni aplikuar pranë organeve të rivlerësimit kalimtar të

gjyqtarëve sipas ligjit nr.86/2016 me qëllim riemërimin në pozicionin e gjyqtarit ? (ç)
 Gjithashtu në zbatim të nenit 199 pika d dhe dh të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” kërkohet nga ana juaj të paraqisni vërtetim nga institucionet përkatëse se *nuk keni masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit* (përfshihen 3 vitet e fundit) dhe se nuk jeni pushuar nga puna në ndonjë rast për shkelje disiplinore.

61. Kandidati Klodian Rado ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me nr. 294 prot, datë 30.04.2019, me të cilën parashtron si më poshtë:

- Në lidhje me kërkesën për plotësimin e mëtejshëm të dokumentave që lidhen me përvojën time profesionale, ju sqarojmë si më poshtë vijon:
- Në dijeninë time, për fat të keq, unë nuk kam e nuk jam pajisur asnjëherë me librezë pune. Të gjithë punëdhënësit e mi të mëparshëm, subjekte publike apo private, brenda apo jashtë Shqipërisë, nuk më kanë kërkuar dhe si rrjedhim nuk më kanë firmosur asnjëherë këtë dokument. Aq më tepër që disa punëdhënës juridikisht nuk ekzistojnë më (Zyra avokatore e Prof Dr Paskal Haxhi).
- Megjithatë, unë jam i gatshëm që ta provoj përvojën time profesionale të punës me dokumenta të tjerë zyrtarë, përfshirë edhe këtë letër sqaruese.
- Siç edhe e kam përmendur në “Kërkesën për Aplikim”, përvoja ime në profesion është multidimensionale, e kombinuar në më shumë se një punësim, dhe përfshin përvojë pune në profesion në të gjitha format e punësimit të njohura në vendet e zhvilluara (punë të paguar me mjete financiare, punë të kompensuar me mjete jofinanciare, punë me kohë të plotë, punë me kohë të pjesshme). Në këto kushte, do të sugjeroja dhe jam i gatshëm që ta provoja karrieren time të deritanishme profesionale në forma të tjera.
- ***Qershor 2003-Tetor 2004: Jurist pranë zyrës avokatore të Prof. Dr. Paskal Haxhi*** (*Qershor 2003 - Tetor 2003: Eksperiencë pune me kohë të plotë (40 orë në javë), e paguar me mjete financiare. Tetor 2003 - Tetor 2004: Eksperiencë pune me kohë të pjesshme (20 orë në javë), e paguar me mjete financiare.*)
- ***Tetor 2003-Tetor 2006: Themelues, anëtar i Këshillit Drejtues të Shoqatës “Qytetërim dhe Drejtësi”, dhe jurist i Shoqatës*** (*Shtator 2003 - Tetor 2004: Eksperiencë pune si jurist i Shoqatës, me kohë të plotë (40 orë pune në javë), punë e kompensuar me mjete jofinanciare.*)
- Meqënëse është një shoqatë e sapohapur prej nesh, unë isha i angazhuar maksimalisht me qëllim që të fillonim të realizonim projektet tona sipas objektit të shoqatës që kishim themeluar vetë, dhe për këtë angazhimi im ka qënë maksimal jo vetëm pas, por edhe para periudhës së themelimit (që nga Qershor 2003, derisa u themelua juridikisht).
- *Tetor 2004 - Tetor 2006: Punë si jurist, me kohë të pjesshmë (mesatarisht mbi 30 orë pune në javë), punë e kompensuar me mjete jofinanciare, me qëllim që të realizonim projektet tona sipas objektit të shoqatës. Prej Tetor 2004, për shkak të angazhimeve të tjera si student në Shkollën e Magjistraturës dhe si pedagog në Universitetin e Tiranë, kalova në angazhim part-time.*
- Tetor 2004-Tetor 2006: Student në Shkollën e Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës, si shkollë profesionale me kohë të plotë, sipas praktikave më të mira të vendeve të zhvilluara, konsiderohet pa dyshim si përvojë profesionale, sidomos duke pasur parasysh që përgjatë kohës në të, neve jemi kompensuar me mjete financiare. Përveçse ligjor, konsiderimi i dy viteve të para të Shkollës së Magjistraturës si përvojë profesionale, është edhe logjik, dhe është në përputhje me praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara, ku jo vetëm shkollat profesionale, por edhe studimet master apo të

doktoraturës (sidomos kur kompensohen me mjete financiare), konsiderohen në cdo rast përvojë profesionale.

- Së pari, angazhimi me kohë të plotë në dy vitet e para të Shkollës së Magjistraturës i një juristi që përzgjidhet pas një konkursi mjaft të vështirë për tu bërë pjesë e këtij programi, e madje duke u kompensuar financiarisht për këtë përvojë, është padyshim tregues që këto dy vite konsiderohen “përvojë pune në profesion” sipas kuptimit të Nenit 147/d (3) të Kushtetutës. Në rast të kundërt, kjo kategori juristësh që kanë zgjedhur këtë lloj karriere, edhe pse të konsideruar gjërësisht si një nga kategoritë e juristëve me nivel mjaft të lartë për shkak të kalimit me sukses të provimit hyrës, do të vendoseshin në pozita të hapura diskriminuose në raport me juristët e tjerë të cilët për shkak të zgjedhjes së tyre, apo për shkak se nuk arritën të kalonin provimin e Magjistraturës, janë angazhuar në një institucion tjetër publik apo privat. Mosnjohja si vjetërsi në profesion e këtyre dy viteve do të vendoste në pozita të padrejta diskriminuose këtë kategori, diskriminim i cili do të binte ndesh edhe me Nenin 17 dhe 18 të Kushtetutës.
- Së dyti, njohja si përvojë profesionale e viteve të angazhimit në programin e trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, është një katalizator i arsyeshëm për të nxitur juristët më të mirë për të hyrë në këtë lloj karriere. Në rast të kundërt, jo vetëm që nuk do të ishte atraktive, por përkundrazi, koha e trajnimit fillestar edhe pse e kompensuar financiarisht, do të ishte si kohë e shkuar dëm në kuptim të viteve të përvojës profesionale për efekt karriere.
- Tetor 2004-Tetor 2006: Pedagog në Universitetin e Tiranës
 - o Fakulteti i Drejtësisë
 - o Fakulteti Filologjik, Dega “Gazetari”
 - o Fakulteti Filologjik, Dega “Histori/Gjeografi” Sqarim:
- Përgjatë dy viteve të para të studimit në Shkollën e Magjistraturës, unë kam qënë edhe pedagog i jashtëm në Universitetin e Tiranës (disa fakultete), madje edhe titullar lëndësh (E Drejtë Kushtetuese - Dega “Gazetari”; E Drejtë Publike - Dega “Histori/Gjeografi”). Kjo punë ka qënë punë e paguar me mjete financiare.
- Tetor 2006-Nëntor 2007: Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë periudhë shih Vërtetimin Nr 1625 Prot, Datë 15.03.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dekretin e Presidentit Nr 5049, Datë 04.10.2006.
- Nëntor 2007-Shtator 2015: Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Për këtë periudhë shih Vërtetimin Nr 1625 Prot, Datë 15.03.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Dekretin e Presidentit Nr 5515, Datë 14.11.2007. Formalisht këtë status e kam mbajtur deri në 18.09.2015, kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë pranoi dorëheqjen time nga detyra e gjyqtarit, me Vendimin Nr 90, Datë, 18.09.2015.
- Tetor 2004-Korrik 2009: Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
- Tetor 2005-Korrik 2008: Pedagog në Fakultetin Filologjik, Dega “Gazetari” dhe Dega “Gjeografi”
- Tetor 2006-Korrik 2008: Pedagog në Universitetin Evropian të Tiranës
- Tetor 2006-Qershor 2010: Pedagog në Universitetin “Justiniani I”
- Mars 2012-Qershor 2012: Pedagog në Universitetin New York Tirana (2012)
- Janar 2009-Qershor 2012: Trajner/ekspert në Shkollën e Magjistraturës. Përgjatë kohës që kam qënë gjyqtar, gjatë gjithë kësaj periudhe kam qënë edhe trajner në Shkollën e Magjistraturës, si dhe pedagog i jashtëm (titullar lëndësh) në disa universitete, si më sipër. Kjo punë ka qënë punë e paguar me mjete financiare.
- Shtator 2012-Gusht 2018: Doktorant në York University, Toronto, Kanada
- Shtator 2012-Gusht 2018: Pedagog në York University, Toronto, Kanada. Përgjatë kësaj periudhe kam ushtruar me kohë të plotë dhe të lidhura pazgjidhshmërisht së bashku këto

dy përvoja profesionale: doktorant dhe pedagog në York University, Toronto, Kanada. Sipas praktikës së këtyre vendeve të zhvilluara, paketa profesionale e punës së kësaj natyre është e tillë që kombinon të dyja këto përvoja të natyrës shkencore, dhe është një punë me kohë të plotë e kompensuar me mjete financiare dhe me sigurime shoqërore e shëndetësore të paguara. Produkti i kësaj punë me kohë të plotë e të pagueshme është i dyfishtë. Nga njëra anë, është prodhimi i një studimi shkencor që bëhet pjesë e Librarisë Kombëtare Kanadeze të studimeve shkencore, dhe nga ana tjetër mësimdhënia me të gjitha komponentët e saj (Lënda: Të Drejtat e Njeriut).

- Tetor 2015-Gusht 2018: Ekspert Ligjor në Kanada (Freelance - Profesionist i Lirë). Pas përfundimit të statusit të gjyqtarit, përvec punës akademike me kohë të plotë në Kanada, siç sqarova më sipër, jam angazhuar dhe kam kryer edhe punë me kohë të pjesshme si ekspert ligjor (profesionist i lirë), i paguar me mjete financiare. Gjatë kësaj periudhe kam kryer disa konsulenca ligjore dhe ekspertiza ligjore për NGO të ndryshme, apo procese gjyqësore në Kanada apo në Mbretërinë e Bashkuar (UK).
- Shtator 2018-(vazhdim): Ekspert i Lartë Ligjor pranë Misionit EURALIUS. Ky është edhe profesioni që jam duke ushtuar aktualisht, dhe është një punë me kohë të plotë (40 orë në javë), e paguar me mjete financiare.
- Në përfundim të këtij sqarimi dëshiroj të theksoj se, që nga koha e pas-përfundimit të studimeve universitare dhe diplomimit tim si jurist, gjatë gjithë kohës në vazhdim, e deri në momentin e shkruarjes të kësaj letre sqaruese, unë kam qënë vazhdimisht i angazhuar maksimalisht e në mënyrë të pandërprerë duke ushtuar profesionin e juristit në përvoja të ndryshme profesionale. Madje, duhet theksuar se angazhimet, në shumcën e kohës, kanë qënë në më shumë se një vend.

62. Me emailin e datës 21.06.2019 kandidati ka depozituar vërtetimin në lidhje me përvojën profesionale pranë zyrës avokatore të Prof. Dr. Paskal Haxhi.

63. Gjithashtu me emailin e datës 12.07.2019 i është kërkuar si vijon: *Në letrën Tuaj sqaruese të datës 26.04.2019 ndër të tjera rezulton se në periudhën tetor 2004-tetor 2006 dhe tetor 2005 dhe korrik 2008, keni punuar si pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, për këtë periudhë kërkojmë nga ana Juaj të paraqisni dokumentacionin si vijon: Kontrata pune (nëse dispononi) ose vërtetime të lëshuara nga ky fakultet për kohën e punës së ofruar si pedagog i jashtëm duke specifikuar konkretisht: lëndet respektive, orët e kryera si pedagog i jashtëm e periudhën e vitit kur ajo është ofruar (gjatë gjithë vitit apo simestrale).*

64. Me emailin e datës 23.07.2019 kandidati në lidhje me kërkesën për sqarime të mëtejshme ndër të tjera ka parashtruar:

- Në lidhje me kërkesën për plotësimin e mëtejshëm të dokumentave që lidhen me përvojën time profesionale, ju sqarojmë si më poshtë vijon:
- Në periudhën Tetor 2004 - Korrik 2009, unë kam ushtuar në mënyrë të pandërprerë funksionin e pedagogut të jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, përgjatë gjithë këtyre viteve akademike, përfshirë të gjitha semestrat akademikë. Kjo vërtetohet nga Vërtetimi i Datës 13.03.2019, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.
- Megjithatë, sic mund të jetë e njohur edhe nga ana juaj, sipas praktikës së kohës, në kuadër të funksioneve si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Publike i këtij Fakulteti, caktonte pedagogët sipas nevojave në Fakultetet të tjera të ndryshme të Universitetit të Tiranës. Pikërisht, në kuadër të kësaj prakike ka qënë edhe caktimi im si: Pedagog në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Filologjik, Dega "Gazetari",

dhe në Fakultetin Filologjik, Dega "Histori/Gjeografi". Në këto fakultetet kam qënë titullar lëndësh: E Drejtë Kushtetuese - Dega "Gazetari"; E Drejtë Publike -Dega "Histori/Gjeografi". Kjo punë ka qënë punë e paguar me mjete financiare.

- Në këto kushte, në përgjigje të pyetjes tuaj, dëshiroj të theksoj se, unë nuk kam me këto Fakultete një kontratë punësimi të vecantë, apo dokumentacione të tjera në lidhje me ta, për shkak se marrëdhënia ime e punës nuk është me ta (madje edhe pagesa realizohej nga Fakulteti i Drejtësisë, i cili ishte edhe punëdhënësi im). I vetmi dokument që firmosja në ato institucione ishin, regjistrat e studentëve dhe procesverbalet përfundimtare të nxjerrjes së notave, të cilat me siguri gjenden në arkivat e këtyre Fakulteteve.

65. Në interpretim unik të nenit 147/d të Kushtetutës dhe nenit 199 pika I shkronja "c" të ligjit nr. 115/2016 rezulton se kusht ligjor për kandidimin në pozicionin e Inspektorit të Lartë të drejtësisë është që kandidati, në momentin e kandidimit, të ketë **jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesionin si jurist**. Madje Kushtetuta bën të qartë se juristët, që kandidojnë në këtë pozicion vakant duhet të përfshihen në rradhës e juristëve më të spikatur në profesion, duke shtuar kështu cilësitë e vecanta dalluese profesionale, që duhet të ketë kandidati për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. KED vlerëson se togfjalëshi "jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesionin si jurist" kërkon që kandidati të ketë kryer efektivisht punën e juristit për mbi 15 vjet. Përvoja 15 vjecare nënkupton se punësimi duhet të jetë me kohë të plotë për gjithë vitet, i provuar rregullisht nga dokumentet zyrtare të vjetërsisë në punë të njohura ligjërish.

66. Duke vlerësuar në tërësi shpjegimet e kandidatit Klodian Rado dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij për vërtetimin e përvojës së punës si jurist, KED vlerëson se kandidati Klodian Rado nuk plotëson kushtin ligjor të përvojës profesionale prej 15 vjet pune në momentin e kandidimit.

67. Rezulton se kandidati Klodian Rado ka përfunduar arsimin e lartë juridik në datën 27.06.2003. Sipas kandidatit, për periudhën Qershor 2003 deri në Tetor 2003 ka punuar si asistent avokat në zyrën avokature të av. Paskal Haxhi, me kohë të plotë prej 40 orë në javë e paguar me mjete financiare dhe Tetor 2003 deri në Tetor 2004, me kohë të pjesëshme prej 20 orë në javë, e paguar me mjete financiare.

68. Për vërtetimin e kësaj periudhe pune kandidati ka paraqitur pranë KED vërtetimin e datës 24.12.2003 të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë në të cilin thuhet se: *I sipërpërmenduri, pra kandidati, është caktuar për të kryer stazhin si asistent pranë anëtarit të Dhomës së avokatisë Tiranë av. Paskal HAXHI i cili ka filluar më datën 01.X.2003 e në vazhdim.*

69. Megjithëse nga KED që në muajin Prill 2019 i është kërkuar kandidatit paraqitja e vërtetimeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore për këtë periudhë, ose librezë e punës ose vërtetim nga organet tatimore, kandidati nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të tillë, duke pranuar se nuk është i pajisur me librezë dhe nuk mund të marr vërtetim nga i ndjeri Paskal Haxhi për periudhën e punës pranë tij. Gjithashtu deklaroi se nuk është në dijeni nëse janë paguar apo jo sigurimet shoqërore, por është gati të provojë vjetësinë në punë pranë këtij avokati me dëshmitar.

70. Nisur nga sa parashtrohet më sipër, KED vlerëson se nuk provohet përvoja në punë profesionale si jurist për kandidatin Klodian rado pranë zyrës së avokatit Paskal Haxhi për periudhën Qershor 2003 deri në Tetor 2004. Edhe nga shkresa e datës 24.12.2003 i Ministrisë

së Drejtësisë vërtetohet se kandidati ka filluar stazhin si asistent pranë avokatit Paskal Haxhi në datën 01.10.2003 dhe jo në Qershor 2003 sikurse pretendon. Referimi në shkresën e mësipërme i të dhënave se z. *Klodian Rado diplomuar në degën e Drejtësisë në UT e Tiranës më datë 27.06.2003 është rregjistruar në numër 589 në rregjistrin e asistencës avokatore në Ministrinë e Drejtësisë*, nuk provon se kandidati ka filluar të punojë si jurist, asistent në zyrën e avokatit në muajin Qershor 2003. Data 27.06.2003 e shënuar në këtë akt vërteton kohën se kur është diplomuar kandidati dhe jo kohën, kur ai është rregjistruar si asistent avokat. Po në këtë shkresë përcaktohet se rregjistrimi si asistent avokat është bërë në bazë të ligjit nr.9109/2003, ligj ky i cili është miratuar pas muajit Qershor 2003, kur pretendon se ka filluar punë kandidati, gjë që përjashton mundësinë, që ai të ketë filluar punë në Qershor 2003. Në përmbajtjen e shkresës të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë është përcaktuar fillimi i stazhit në datën 01.10.2003, gjë që minimalisht vërteton se koha kur kandidati ka filluar stazhin si asistent është pikërisht data 01.10.2003. Për sa mësipër nuk provohet, që kandidati të ketë ushtruar punën e asistent avokatit për periudhën Qershor 2003 deri në 01.10.2003.

71. KED vlerëson se vërtetimi për rregjistrimin si asistent avokat i marrë nga Ministria e Drejtësisë me datë 24.12.2003 nuk provon se kandidati ka ushtruar këtë detyrë në periudhën Tetor 2003 deri në Tetor 2004 me kohë të pjesëshme sikurse pretendon. Sipas nenit 29 të ligjit nr.9109/2003, marrëdhënia e punës në këtë rast realizohet midis asistentit dhe avokatit, ndërsa Ministria e Drejtësisë ishte vetëm organi që bënte rregjistrimin e personave që fillonin stazhin si asistent pranë një zyre avokatie. Vetëm pas përfundimit të periudhës së stazhit si asistent prej një viti, personi mund të merrte pjesë në provimin për kualifikimin e ushtrimit të profesionit të avokatit. Marrëdhënia e punës në këtë rast duhet të vërtetohet nga punëdhënësi, që ishte avokati, ku kandidati kishte ofruar shërbimin si asistent, nëpërmjet akteve librezë pune të plotësuar nga punëdhënësi, ose rregjistër themeltar ose vërtetimit të Institutit të sigurimeve shoqërore për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore mbi pagën për periudhën e punës, ose listpagesa të dorëzuara rregullisht në drejtoritë e sigurimeve shoqërore. Marrëdhënia e punës sikurse pranon kandidati ka qënë me pagesë dhe në këtë drejtim vërtetimi i saj duhet të bëhet detyrimisht nga organet kompetente, që mbajnë kontributet e sigurimeve shoqërore, pagesa këto që janë të detyrueshme të kryhen nga cdo punëdhënësi në kushtet e punësimeve të ligjshme.

72. Aktet bazë, që vërtetojnë marrëdhënien e punës e llojin e punës së kryer janë librezat e punës dhe rregjistri themeltar të cilat konsiderohet akte me fuqi të plotë provuese sipas nenit 253 të K.Pr.Civile. Një gjë e tillë është pranuar në mënyrë unike nga gjithë legjislacioni shqiptar ndër vite si ai para viteve 1990 dhe deri aktualisht, duke shmangur cdo lloj diskutimi mbi dokumentat ligjore që vërtetojnë përvojën e punës. Kështu në urdhëresën e qeverisë nr.14 datë 6.10.1958 në nenin 1 të të cilës thuhet se: **Libreza e punës është dokumenti zyrtar me anën e të cilit punëtori ose nëpunësi vërteton para administratave të ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave:** a) gjëndjen e marrëdhënies së tij në punë; b) cilësinë profesionale (profesionin, specialitetin dhe kategorinë); c) vjetërsinë e përgjithëshme në punë, vjetërsinë në punë të pa ndërprerë dhe pagën mesatare; ç) dallimet në punë dhe d) gjëndjen shëndetësore në kohën e hyrjes në punë të ndryshme.

73. Janë po këto dokumente që ligjërisht provojnë ekzistencën e një marrëdhënie pune dhe llojin e punës bazuar në rregulloren nr.1 dt.21.10.2008 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Gjithashtu sipas Kodit të Punës, marrëdhënia e punës vërtetohet nëpërmjet kontratës së punës neni 12, rregjistrin themeltar (neni 36 e 95), pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për cdo muaj pranë organeve tatimore. Megjithëse kishte mundësi efektive për paraqitjen e

akteve nga instituti i sigurimeve shoqërore, pasi është njoftuar për plotësim të dokumentacionit në muajin Prill 2019 kandidati nuk ka paraqitur dokumenta zyrtare për të vërtetuar periudhën e tij të punësimit si asistent avokat. Gjithashtu nuk u vërtetua se kandidati të ishte licensuar si avokat pas realizimit të periudhës së stazhit sipas ligjit nr.9109/2003.

74. Kandidati nuk paraqiti asnjë dokument ligjor për të provuar marrëdhënien e tij të punësimit si asistent pranë zyrës avokatore Paskal Haxhi në periudhën e pretenduar. Përvoja në punë, si kusht punësimi në të gjitha pozicionet e administratës publike të rregulluara me ligje të posacëm, duhet të vërtetohet me akte zyrtare si librezë pune ose vërtetime të nxjerra nga rregjistrat themeltar ose listpagesat. Ky standart provueshmërie përbën një garanci për zbatimin e barabartë të ligjit për cdo shtetas, që kandidon në cdo vend pune të administratës publike, ku kërkohet eksperiencia në punë si kriter kualifikimi ose përzgjedhje për punësim për efekt të një niveli sa më të lartë profesional. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ kushtetues monokratik. Nisur nga niveli i lartë i rëndësisë, që paraqet detyra e inspektorit, shkalla e provueshmërisë së kriterëve ligjore sic është përvoja e punës si kusht për kandidimin në këtë pozicion duhet të jetë në të njëjtin nivel ose më e lartë se ajo e përvojës në punë, që kërkohet për pozicione të tjera pune në administratën publike. Pozicioni kushtetues i organit të inspektorit të lartë të drejtësisë kërkon shmangien e cdo lloj dyshimi për punësimin mbi 15 vjet të kandidatit, gjë që kërkon domosdoshmërisht vërtetimin e kësaj përvoje me akte zyrtare me fuqi të plotë provuese sic u cituan mësipër.

75. Në kushtet, kur kandidati nuk disponon asnjë prej akteve zyrtare të sipërcituar, atëherë vërtetimi i marrëdhënies së tij të punës si përvojë profesionale pranë avokatit Paskal Haxhi nuk mund të bëhet me dëshmitar ose me deklarata noteriale. Marrëdhënia e punës vëretohet me librezë punë, listpagesa të depozituara në sigurimet shoqërore ose rregjistrin themeltar dhe kur këto akte nuk ekzistojnë pasi janë zhdukur me vendim gjyqsor sipas nenit 388 I K.Pr.Civile. Në kushtet, kur kandidati nuk ka paraqitur asnjë dokument që ligjërisht të vërtetojë marrëdhënien e punës pranë kësaj zyre avokatie, KED vlerëson se kandidati nuk ka provuar ligjërisht përvojën e punës profesionale si jurist për periudhën Qershor 2003 deri në Tetor 2004 të pretenduar në këtë zyrë avokatie. Prandaj kjo periudhë nuk mund të njihet si përvojë pune profesionale në kuptim të nenit 199/1/c të ligjit nr.115/2016.

76. Gjithashtu kandidati ka shpjeguar se për periudhën Tetor 2003 deri në Tetor 2004 ka punuar me kohë të plotë prej 40 orë në javë si jurist në Shoqatën *Qytetërim e Drejtësi*. Më tej ka vijuar punën po në këtë shoqatë me kohë të pjesëshme 30 orë në javë deri në Tetor 2006. Lidhur me punën në këtë shoqatë kandidati ka pretenduar se ka qënë një punë e kompesuar me mjete jofinanciare. Sipas tij ajo duhet të konsiderohet përvojë pune profesionale, pasi përbënte një punë vullnetare. Edhe për këtë periudhë të pretenduar punësimi, kandidati nuk ka paraqitur asnjë dokument, që ligjërisht provon marrëdhënien e punës si librezë punë, kopjo të rregjistrin themeltar, vërtetim nga sigurimet shoqërore për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

77. I vetmi akt, që ka paraqitur kandidati është një vërtetim i datës 23.04.2009, i lëshuar nga kryetari i shoqatës, në të cilën thuhet se kandidati nga data 10.10.2003 deri në Tetor 2006 ka qënë anëtar i bordit të shoqatës "*Për qytetërim e Drejtësi*" dhe ka ushtruar detyrën e juristit pranë kësaj shoqate në periudhën e pretenduar nga kandidati. Nga KED u administrua dokumentacioni për rregjistrimin e kësaj shoqate në Gjykatën e Tiranës nga ku rezultoi se ajo ishte rregjistruar me vendimin nr.790 dt.10.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë. Gjithashtu, u administruan akti i themelimit dhe statuti i shoqërisë. Sipas vendimit nr.790 datë

10.10.2003 dhe aktit të themelimit, rezulton se kandidati Klodian Rado ka qënë anëtar i këshillit drejtues të shoqatës. Kjo shoqatë ka për qëllim të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, të mbrojtë të drejtat e liritë themelore të njeriut duke dhënë asistencë ligjore falas, të bëjë botime, të organizojë konferenca etj. Në të gjitha aktet e administruara pranë gjykatës nuk rezulton që kandidati të ketë ushtruar detyrën e juristit të shoqatës. Po ashtu nuk është paraqitur asnjë dokument i lëshuar nga institucionet shtetërore si pagesë kontributesh të sigurimeve shoqërore që të vërtetojë se kandidati ka qënë në marrëdhënie pune pranë kësaj shoqate ne periudhën Shtator- Tetor 2003 deri në Tetor 2006.

78. KED vlerëson se vërtetimi i paraqitur nga kryetari i shoqatës nuk provon që kandidati të ketë ushtruar detyrën e juristit në periudhën Tetor 2003 deri në Tetor 2006. Sikurse u citua më sipër, marrëdhënia e punës vërtetohet nga dokumente të njohura ligjërish si akte për vërtetimin e marrëdhënies së punës si librezë e punës, rregjistri themeltar dhe vërtetimet nga sigurimet shoqërore për periudhën e punësimit. Vërtetimi i datës 23.04.2019 nuk ka vlerë provuese për marrëdhënien e punës. Sipas nenit 10 të statutit të shoqërisë është këshilli drejtues, që mund të punësojë personelin e zyrave të shoqatës. Duke qënë se për të njëjtën periudhë kandidati ka mbajtur pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues të shoqatës, atëherë ai paraqitet njëkohësisht në pozitën e punëdhënësit. Si rrjedhim vërtetimi i lëshuar për ushtrimin e detyrës së juristit prej tij në shoqatë në të njëjtën kohë, kur ka qënë anëtar i këshillit drejtues dhe themelues i shoqatës përbën një akt i njëanëshëm me karakter deklarativ, pasi personi punëdhënës nuk mund të provojë punësimin e tij. Nuk ka asnjë akt të mbajtur nga këshilli drejtues në vitet 2003 për punësimin e kandidatit si jurist në periudhën e pretenduar prej tij. Kështu që nuk provohet se mbi cilat akte është bazuar kryetari I shoqatës në lëshimin e vërtetimit të datës 29.04.2019 për detyrën e ushtruar nga kandidati në periudhën 2003-2006.

79. Në vendimin gjyqësor të regjistrimit të shoqatës përcaktohet se ndalohet cdo formë e shpërndarjes së fitimit ose përfitimit material të shoqatës prej personave, që janë subjekt i statusit ose i aktit të themelimit me përjashtim të pagesës së pagave, rrogave, pagesave ose shpërblimeve dhe kompesimeve, që rrjedhin nga kontrata e punës. Në përputhje me këtë përcaktim ushtrimi i detyrës së juristit në shoqatë duhet të provohej me dokumenta ligjore. Fakti, se kandidati ka ofruar një punë vullnetare nuk e përjashton punëdhënësin nga detyrimi për deklarimin e tij pranë organeve të sigurimeve shoqërore dhe tatimore si person të punësuar duke paguar minimalisht kontributet e sigurimeve shoqërore. Vetëm në këtë situatë mund të provohej në mënyrë të plotë periudha e punës dhe detyra konkrete e mbajtur nga subjekti. Në të kundërt punësimi I personit do të ishte i paligjshëm dhe si I tillë ai nuk mund të konsiderohej përvojë pune profesionale si kusht kandidimi.

80. Veç sa mësipër, nga kandidati nuk u paraqit asnjë veprimtari ose produkt i punës së ushtruar prej tij si jurist I kësaj shoqate në periudhën Tetor 2003 deri në Tetor 2006, siç mund të jene botime, konferenca, përfaqësime ligjore të qytetarëve etj. Pra edhe në kuadër të të quajturës punë vullnetare të pretenduar nga kandidati ai nuk paraqiti asnjë akt, që të faktojë veprimtarinë konkrete të ushtruar prej tij në shoqatë si jurist në periudhën, që pretendon prej 3 vjetësh. Duke qënë se neni 199/1/c I ligjit nr.115/2016 kërkon një përvojë pune profesionale jo më pak se 15 vjet atëherë është e detyrueshme që kandidati të provojë se efektivisht ka ushtruar punën si jurist për vitin e plotë Tetor 2003 deri në Tetor 2004 ose pjesërisht Tetor 2004-Tetor 2006, duke paraqitur produkte të punës së tij, gjë që nuk u provua nga kandidati. Për sa mësipër rezultoi se kandidati nuk ka provuar ligjërish përvojën e tij profesionale për periudhën Tetor 2003 deri në Tetor 2006 si jurist në shoqatën “Për qytetërim e drejtësi”.

81. Periudha tjetër e punësimit të deklaruar nga kandidati, është ajo nga Tetori 2004 e në vazhdim kur ai kishte punuar si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë, Fakultetin Filologjik dhe, njëkohësisht, në periudhën Tetor 2004 deri në Tetor 2006 kishte qënë student i shkollës së magjistraturës.

82. Por, KED vlerëson se periudha prej dy vjetësh, konkretisht Tetor 2004 deri në Tetor 2006, e realizimit të programit fillestar të formimit të Shkollës së Magjistraturës nuk konsiderohet përvojë pune profesionale. Periudhat e dy viteve të para të shkollës së Magjistraturës megjithëse janë me shpërblim, konsiderohen vite shkollore, gjë që është përcaktuar shprehimisht në nenet 13 e 14 të ligjit nr.8136/1996 i ndryshuar. Juristët, që kanë konkurruar dhe fituar Shkollën e Magjistraturës kanë hequr dorë vullnetarisht nga ushtrimi i detyrës së juristit duke ndjekur programet shkollore për tu diplomuar në përfundim të kësaj shkolle me titullin magjistrat. Në përputhje me nenin 14 dhe 18 të ligjit nr.8136/1996 periudha një vit e programit teorik konsiderohet vit shkollor, ndërsa viti i dytë i shkollës njihet si vit praktik i stazhit paraprofesional. Vetëm viti i tretë i shkollës, i konsideruar si stazhi profesional sipas nenit 14 të ligjit nr.8136/1996, është periudhë pune gjatë të cilës, sipas nenit 21 të ligjit, ata gëzojnë të njëjta te drejta e detyrime si magjistratët (gjqqtar e prokuror). Në përfundim të analizës së mësipërme, KED vlerëson se periudha e ndjekjes së formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitet 2004-2006 nuk konsiderohet si përvojë pune profesionale, pasi në këtë periudhë kandidati nuk ka ushtruar detyrën e juristit, por ka ndjekur programin teorik e praktik paraprofesional të shkollës për të marr njohuritë e duhura në funksion të diplomimit të tij si magjistrat i ardhëshëm. Shpërblimi i dhënë në këtë rast nuk konsiderohet pagesë, por një lloj burse për të mundësuar frekuentimin me kohë të plotë me shkëputje nga puna të proceseve mësimore për kandidatët që kualifikohen si fitues në konkurim, të cilët në përfundim do të diplomohet dhe do të ushtrojnë detyrën e gjyqtarit ose të prokurorit. Të njëjtin trajtim ligjor për periudhën e vitit teorik dhe vitit të programit paraprofesional bën edhe ligji aktual nr.115/2016 në nenin 263 të tij.

83. Nga vërtetimi i dates 25.07.2019 i Fakultetit të Drejtësisë rezulton se kandidati ka mbajtur detyrën e pedagogut të jashtëm me kohë të pjesëshme për vitet akademike 2004-2005, 2005-2006, 2006-2007, 2007-2008 simestri i dytë. Nga ky vërtetim provohet se periudha e punësimit si pedagog i jashtëm ka nisur pas Tetorit 2004 dhe është e kufizuar si në orare ashtu edhe në periudhën e vitit kur ofrohet. Duke qënë me kohë të pjesëshme dhe simestrale, ajo nuk mund të konsiderohet si vit i plotë punësimi, pasi bie ndesh me kuptimin standart të përvojës së punës një vjecare që i referohet kohës së plotë të punës (40 orë java) së ushtruar për një vit. Në rastin më të mirë kjo periudhë punësimi nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj në vit. Atëherë për periudhën Tetor 2004 deri në Tetor 2006 periudha e punësimit do të kufizohet vetëm në një vit, gjë do të ndikonte në uljen e metejshme të përvojës së punës profesionale të kandidatit.

84. Edhe në rast se punësimi si pedagog i jashtëm do të vlerësohej si periudhë përvojë pune profesionale për 2 vite në përputhje me vitet kalendarike, kur ajo është ushtruar Tetor 2004 deri në Tetor 2006, përsëri rezulton se kandidati nuk plotëson përvojën e punës mbi 15 vjet deri në muajin Mars 2019 kur ai ka kandiduar në pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këshut, nga muaji Tetor 2004 deri në muajin Mars 2019, kur ka kandiduar, pa analizuar më tej në këtë periudhë nëse kandidati ka apo jo ndërprerje të tjera të punës të tij për efekte studimore, del se kandidati ka ushtruar profesionin e juristit, gjyqtarit dhe lektorit

gjithsej për maksimalisht 14 vjet e 6 muaj. Pra rezulton se nuk plotësohet kushti ligjor i kandidimit për përvojë pune profesionale për jo më pak se 15 vjet para momentit të kandidimit sipas nenit 199/1/c të ligjit nr.115/2016 dhe nenit 147/d/3 të Kushtetutës.

85. Bazuar në gjetjet dhe aryetimet e ligjit të zbatueshëm të si më sipër, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Klodian Rado nuk ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale sipas pikës 3 të nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016. Prandaj, në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 jemi në kushtet e ndalimit të kandidimit të kandidatit Klodian Rado për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

86. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ...*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati Klodian Rado nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidati Klodian Rado nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

87. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit* nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidati Klodian Rado nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidati Klodian Rado nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

88. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati Klodian Rado nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidati Klodian Rado nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

89. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Klodian Rado në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 5 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Klodian Rado, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Klodian Rado.
3. Kandidati Klodian Rado ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI

